

Zhvillohet analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor

Më datë 25 Janar 2017, në ambientet e **Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë**, u zhvillua analiza e Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor. Në analizë morën pjesë Sekretari i Përgjithshëm i KLSH-së zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Xhaferr Xhoxhaj dhe Kryeaudituesi z. Niko Nako. Të ftuar të veçantë ishin Rektori i Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, z. Roland Zizi dhe Kryetari i Bashkisë Vlorë z. Dritan Leli.

Fjala e hapjes u mbajt nga zj. Nano, e cila falenderoi Rektoren e Universitetit për mikpritjen dhe bashkëpunimin, sfatin akademik dhe studentët për pjesëmarrjen, Kryetarin e Bashkisë Vlorë, përfaqësuesit e shoqërisë civile: zj. Brikena Puka, Qendra “Vatra”, zj. Alketa Dhimitri, Qendra Rinore Vlorë, z. Robert Murataj, Qendra për Ndryshim Albania, z. Pjerin Dema, Qendra “Aarus”, Vlorë, zj. Besa Hoxha, Agjencia e Zhvillimit “Auleda” etj, mediat e shkruara dhe ato vizuale të pranishme në analizë si TV 6+1, Fokus TV, Vlora News, Klan TV etj.

Zj. Nano vlerësoi punën dhe arritjet e departamentit përgjatë vitit 2016, sidomos për përfundimin me sukses të dy projekteve Pilot.

Rektori i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, z. Roland Zizi, vlerësoi punën e KLSH dhe nevojën e intensifikimit të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Në përfundim, Rektori falenderoi KLSH për serinë e kolanës “Botimet e KLSH” e cila iu bë dhuratë Bibliotekës së Universitetit.

Analiza u vijua nga Drejtori i Departamentit z. Xhafer Xhoxhaj, i cili bëri një përmbledhje të shkurtër të veprimtarisë audituese, duke u përqendruar kryesisht në plotësimin e programit vjetor të auditimit, rezultatet e tyre të shprehura në rekomandime për përmirësime e ndryshime ligjore, masat organizative, ato administrative dhe disiplinore, masat për shpërblimin e dëmit së bashku me vlerën e tyre, rastet dhe numri i kallëzimeve penale. Gjithashtu z. Xhoxhaj u ndal dhe në veprimtarinë e audituesve të departamentit në drejtim të analizës dhe shqyrtimit të kërkesë-ankesave, pjesëmarrje në trajnime, cilësinë e auditimit, zbatimin e kodit etik si dhe vlerësimin e veprimtarisë së secilit auditues.

Më pas fjalën përshëndetëse e mori Kryetari i Bashkisë Vlorë, z. Dritan Leli, i cili vuri theksin tek ndihma që KLSH ka dhënë për përmirësimin e gjendjes financiare të bashkisë dhe veçanërisht për rekomandimet lidhur me caktimin e Ujësjiellës sha në cilësinë e agjentit tatimor, duke sjellë shtimin e të ardhurave të bashkisë në vlerën 60 milion lekë. Z. Leli bëri prezent se do të vazhdojë të jetë i hapur për zbatimin e ligjit dhe se ndihma e KLSH në këtë drejtim është e madhe.

Raport Analiza e plotë e veprimtarisë për vitin 2016 u prezantuar e detajuar nga z. Niko Nako, Kryeauditues në këtë Departament. Gjate prezantimit të tij z. Nako u shpreh se për vitin 2016 nga 34 auditime të *programuar/planifikuar* janë realizuara dhe evaduar 38 auditime. Përgjithësisht auditimet kanë mbuluar periudhën e aktivitetit 2-3 vjeçare (*viti 2013 deri Qershor 2016*), ku krahas 27 bashkive janë mbuluar me auditim (*me zgjedhje*) rreth 170 Njësi Administrative (*ish-Komuna*), kryesisht për aktivitetin financiar, prokurimet publike, taksat vendore, administrimin e aseteve etj.

Më konkretisht janë audituar 27 Bashki, 4 Këshilla Qarku, 2 Prefektura, 1 Ndërmarrje Varësie, 2 auditime Tematike; si dhe 2 auditime të Zbatimit të Rekomandimeve të vitit 2015 dhe 2016. Të ndara sipas llojit auditimet, paraqiten: 32 auditime të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, 2 auditime përputhshmërie (*Pilot*), 2 auditime Tematike, si dhe 2 auditime “Mbi zbatimin e rekomandimeve”.

Në mënyrë të përmbledhur, për të gjitha subjektet janë rekomanduar 2 masa për përmirësimet ligjore, 627 masa organizative, masa për shpërbllim dëmi në vlerën prej 3.6 miliard lekë dhe 627 masa disiplinore dhe administrative.

- Lidhur me dëmin ekonomik të konstatuar, masa e dëmit ekonomik dhe të ardhura të munguara, ose shpenzimet jo efektive, janë në vlerën prej 3,6 miliard lekë, nga të cilat 1,3 miliard lekë i përket dëmit ekonomik të konstatuar në 35 subjekte dhe 2,3 miliard lekë të ardhura të munguara (shpenzime jo efektive).
- Sipas fushave përkatëse dëmi i konstatuar ndahet në: 439 milion lekë në fushën e prokurimeve publike, 343 milion lekë në administrimin e asetëve, 69 milion lekë në pagesa të kundërligjshme për shpenzimet operative, 55 milion lekë në sistemin e pagave, shpërblime dhe sigurime shoqërore, 52 milion lekë në fushën e urbanistikës (*taksa për ndikimin në infrastrukturë, si dhe 18 milion lekë në zërin të tjera*).
- Janë rekomanduar 627 masa organizative; 739 masave disiplinore dhe administrative, nga të cilat: 184 masa disiplinore për punonjës me status nëpunësi civil, 172 masa për punonjës me kodin e punës, si dhe 383 masa administrative.
- Janë bërë 20 kallëzime penale, për 81 persona, 15 subjekte të audituara me efekte financiare, të shprehura në dëm ekonomik me vlerë 118 milion lekë; 8 indicie për kallëzim penal për 21 persona, 3 vlerësime për kallëzim penal.
- Janë trajtuar gjatë procesit auditues 62 kërkesë/ankesa, nga të cilat 18 për çështje të administrimit financiar dhe prokurimeve, 22 në fushën e administrimit të asetëve dhe 22 për çështje të ndryshme, nga të cilat 7 kanë rezultuar të drejta, 29 kanë rezultuar jashtë kompetencave dhe 2 kanë rezultuar të pa drejta.
- Është plotësuar objektivi duke realizuar mesatarisht 20 ditë trajnime për secilin auditues në fushat si Menaxhimi financiar dhe kontrolli, Materialiteti dhe risku, Auditimi i prokurimeve publike, Auditimi i menaxhimit të Aseteve etj. Kujdes është treguar për trajnimin e audituesve të rekrutuar rishtazi, duke arritur objektivin e 25 ditë trajnimi/vit si dhe duke i përfshirë në grupe pune me auditues me eksperiencë në auditim.
- Audituesit e Departamentit kanë qenë të pranishëm me artikujt e tyre, duke dhënë një kontribut modest në ngritjen e rolit dhe të prestigjit të institucionit përballë opinionit publik nëpërmjet 10 shkrimeve në gazeta të përditshme.

Fjalën e mori dhe audituesja e Kontrollit të Cilësisë zj. Brunilda Zeneli, e cila bëri një përmbledhje të problemeve që kanë rezultuar nga kontrolli i cilësisë së dosjeve të evaduar gjatë këtij viti kryesisht në lidhje me pamjaftueshmërinë e informacionit paraprak për subjektet e audituara, rëndësinë e analizës së riskut, njohjen e bazës ligjore, trajtimin e observacioneve etj.

Në vijim të punimeve të analizës, audituesit referuan lidhur me botimet e kolanës së KLSH-së, “Analiza e Riskut”, volumi I dhe II dhe botimin “Forcimi i Kapaciteteve të auditimit të jashtëm në Shqipëri”.

Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor

Analiza Vjetore 2016

Audituesit e rinj Angjela Nesturi dhe Xhein Xhindoli, në bashkëpunim me studentët praktikant, referuan lidhur me botimin “Audituesit e KLSH në shtypin e përditshëm”, (botim i vitit 2016) pjesë e kolanës së botimeve KLSH, si dhe temën “Perceptimi për institucionin e KLSH, brenda dhe jashtë”.

Në përfundim z. Xhoxhaj bëri prezent objektivat e departamentit për vitin 2017, duke theksuar se arritjet e vitit të lënë pas duhet të shërbejnë si bazë e qëndrueshme për të përballuar sfidat e auditimit, veçanërisht sot, në kushtet e krijimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të mëdha, dhe se nga audituesit e departamentit do të vijohet të punohet në drejtim të pavarësisë, objektivitetit, kompetencës, bashkëpunimit dhe integritetit.

